ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **ARKIVI I KOSOVES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **12500-24-4478-2-2-3**

Sa i përket tenderit për **Konkursi i Projektimit për Projektin Ideor dhe Kryesor të Ndërtesës së Arkivit. Ndërkomunal të Gjilanit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**DEA GROUP SH.P.K.**
NUI	**811454636**
Adresa	**PRISHTINE**
Vendi	**KOSOVO**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**044815477**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**ARTON ZEQIRI**
Adresa elektronike	**deagroup0@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**15.11.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Konkursi i Projektimit për Projektin Ideor dhe Kryesor të Ndërtesës së Arkivit. Ndërkomunal të Gjilanit

B06 Njoftim per Konkursin e Projektimit 08.05.2024 11:24

B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara 18.06.2024 13:56

Template per Dosja e Tenderit_18.06.2024.Doc 18.06.2024 13:59

Dokumenti shtojca 08.05.2024 11:08 Template per Dosja e Tenderit (14).doc

Dokumenti shtojca 08.05.2024 11:09 PROJEKT_-_OBJEKTI_I_ARKIVIT.PDF

Dokumenti shtojca 20.05.2024 11:22 Saqrime Shtrese nga nje OE_20.05.2024.rar

Dokumenti shtojca 03.06.2024 09:58 Sqarim Shtesë _03.06.2024.pdf

Dokumenti shtojca 03.07.2024 14:31 Procesverbali i pranimit te dokumenteve te OE.pdf

Dokumenti shtojca 07.08.2024 16:00 Njoftimi mbi vendimin_Faza I.pdf

Dokumenti shtojca 15.08.2024 09:49 Vendim pezullimi_001.pdf

Dokumenti shtojca 16.08.2024 08:42 VENDIM MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR RI-SHQYRTIM_16.08.2024.pdf

Dokumenti shtojca 26.08.2024 15:33 Vendim pezullimi_OSHP.pdf

Dokumenti shtojca 18.10.2024 13:12 Njoftim per Projekti e Projektimit ANGJ_OSHP-OE.pdf

Dokumenti shtojca 18.10.2024 13:12 Vazhdimi i Validitetit te ofertes.pdf

Dokumenti shtojca 23.10.2024 15:34 Vazhdimi i Validitetit te ofertes.pdf

Përshkrimi i çmimeve Pershkrimi i çmimeve-shqip.doc 08.05.2024 11:23

Kërkesë për rishqyrtim – arkivi 12.08.2024 15:46

VENDIM MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR RI-SHQYRTIM.pdf 11.06.2024 10:15

VENDIM MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR RI-SHQYRTIM_16.08.2024.pdf 06.11.2024 09:46

Kërkesë për dokumentacione shtesë _Pranushmeria_DEA.pdf 30.10.2024 11:34

B58 12500-25-4478-2-2-3.pdf 01.11.2024 15:58

B12 Proces verbali i hapjes se Tenderve 30.10.2024 11:21

08.11.2024 15:39 Vendim mbi kerkesen per rishqyrtim.pdf

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Pas pranimit te vendimit B58 12500-25-4478-2-2-3.pdf 01.11.2024 15:58 te pa kenaqur me kete vendim me daten 02.11.2024 kemi ber kerkese per qasje ne Dokumente Publik me daten 05.11.2024 kemi pranuar emailin se:

I Nderuar,

Sipas kërkesës suaj të parashtruar ju lejohet qasja e kërkuar sot me 05.11.2024 nga ora 14:00.

Me Respekt,

Me daten 05.11.2024 ne ora 14:00 kemi qene present ne Auteritetin Kontraktues ku dhe jemi takuar me zyrtaren e prokurimit Eldina Arifi e cila na ka then se duhet te presim pak,ndersa qasja ka filluar pas 2 ore pritje .Gjate procesit te qasjes zyrtarja e prokurimit na ka then se duhet te nenshkruani ketu dhe ti merrni dokumentet sepse ashtu I keni kerkuar ne kopje fizike dhe nuk lejohet ti shiqoni , edhe pse ne kemi kerkuar qe ti shohim dokumentet pasi qe ne DT disa dokumente jane kerkuar te jene origjinale apo kopje te noterizuara por e njejta nuk na eshte lejuar.

Pas këtij procesi, ne kemi bërë kërkesën për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues (AK), ku kemi ngritur pretendimet tona, të cilat janë shpallur si të pabazuara dhe qëllimisht janë shtrembëruar duke u përpjekur të ndryshohet konteksti i pretendimeve tona.

Detajet tjera do ti paraqesim te pjesa 7. Faktet dhe argumentet

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi
Neni 2 Fushëveprimi
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo – Diskriminimi
Neni 28 Specifikimet teknike
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i tendereve
Neni 60 Kriteret për dhenjen e kontratë
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi 1 OE I shpallur fitues GM Architecture sh.p.k ka plotesuar Deklaraten per Kerkesen per sekrete afariste te pjesa Informacionet sekrete

thuhet se:Perveq pjeses Oferta financiare te gjitha pjeset tjera te dosjes se tenderit jane secrete afariste te OE GM Architecture dhe vetem per vlersimin nga komisioni I Arkivit te Kosoves.

Ndersa te pjesa e deklarimit thuhet se:

OE te cilet ne raste kur kerkojne qasje ne dokumentacionin tone, nga ky dokumentacion marrin referime per konkurrence ne ofertat tjera. Gjithashtu, dhe

forma te ndryshme per manipulim me stafin tone, qe te bashkepunojne gjate pergatitjes se dosjes dhe me tutje. Gjithashtu behet fotografimi i dokumenteve (kontrata, dif loma, certifikata) dhe perdoren jashteligjshem dhe ne dem te kompanise tone. Per kete, kemi deshmi nga rastet e tjera.

AK ka vepruar ne kundershtim me ligjin 04/L-042 perkatesisht me nenete 68-69 dhe nenin 11 te ketije ligji pasi qe nuk na ka ofruar edhe pjeset e dokumentacionit administrative ose OE I shpallur fitues nuk I posedon pasi qe neve nuk na jane dhene pjesa e Specifikimeve teknike te detyrushme

e cila eshte se bashku me Detyren Projektuese e cila eshte kusht administrative dhe duhet te nenshkruhet dhe vuloset nga OE.

Ky pretendim nga ana jonë është plotësisht i bazuar sepse Operatorit Ekonomik (OE) i shpallur fitues nuk ka dorëzuar fare specifikimet teknike të detyrueshme. Për më tepër, AK e arsyeton OE të shpallur fitues me pretendimin se kjo nuk ka qenë kërkesë në dosjen

e tenderit. Duke u bazuar në UDHËZUESIN Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, pika 10, Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve.

Autoriteti Kontraktues thotë se dorëzimi i specifikimeve teknike nuk është kriter në dosjen e tenderit dhe, për më tepër, thotë se OE duhet të plotësojë ato për aplikim në fazën e parë, gjë që është e papranueshme pasi që faza e parë duhet të dorëzohet vetëm projekti dhe nuk duhet të përdoret vula dhe emri i kompanisë pjesëmarrëse. Nëse OE fitues ka dorëzuar specifikimet teknike në fazën e parë të nënshkruara dhe vulosura, sipas UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, pika 10, Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, atëherë ky OE ka zbuluar identitetin dhe duhej të eliminohej qysh në fazën e parë. Nëse OE pjesëmarrës nuk dorëzon Aneksin 1, SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME, si mund të kërkojë AK që ai ta dorëzojë projektin detal pasi që në specifikimet

teknike thuhet qartë se OE i shpallur fitues duhet ta dorëzojë projektin kryesor në bazë të specifikimeve teknike si më poshtë:

1.

1. **Hartimi i projektit kryesor (zbatues):**

1.1. Të hartohet projekti kryesor-zbatues sipas projektit të rishikuar ideor, duke i përfshirë të gjitha fazat (arkitekturën, strukturën, instalimet elektrike, të ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet makinerike, elaboratin e mbrojtjes nga zjarri).

1.2. Projekti kryesor duhet të përmbajë:

1.2.1. Përshkrimin teknik;

1.2.2. Inçizimin gjeodezik të parcelës në të cilën shtrihet ndërtesa ;

1.2.3. Situacionin e gjerë duke përfshirë edhe kontekstin më të gjërë urban P=1:500 dhe në harmoni me kushtet ndërtimore;

1.2.4. Situacionin e ngushtë P=1:250 ose P=1:100;

1.2.5. Bazën e bodrumit, P=1:50

1.2.6. Bazën e përdhesës, P=1:50

1.2.7. Bazën e katit 1, P=1:50

1.2.8. Bazën e katit 2, P=1:50

1.2.9. Bazën e katit 3, P=1:50

1.2.10. Bazën e kulmit, P=1:50

1.2.11. Prerjet karakteristike, së paku dy prerje – një gjatësore dhe tërthore, P=1:50 (dimensionet, kotat nivelore, materializimi, etj.)

1.2.12. Dukjet e të gjitha faqeve të ndërtesës, P=1:50

1.2.13. Detajet, P=1:25 ose P=1:10

1.2.14. 3d prezantimin e ndërtesës dhe animacionin

1.2.15. Fazën e strukturës

1.2.16. Fazën e instalimeve elektrike

1.2.17. Fazën e ujësjellësit dhe kanalizimit

1.2.18. Fazën e instalimeve makinerike

1.2.19. Elaboratin e mbrojtjes nga zjarri.

Nëse ky OE nuk i ka pranuar këto specifikime, të cilat pranohen në momentin kur një OE i nënshkruan dhe i vulos, i bie që nuk do të plotësohen këto 19 pika sipas specifikimeve teknike.

Për më tepër, këtë pikë, siç edhe ju bashkëngjesim dëshmitë, e sqaron shumë qartë edhe UDHËZUESI Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, pika 10, Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, i cili tregon qartë se tenderi që nuk i dorëzon specifikimet duhet të refuzohet.

Në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim, AK e pranon se OE i shpallur fitues nuk ka dorëzuar Aneksin 1, SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME.

Deshmit per kete argument i gjeni te bashkangjitura.

Pretendimi 2 **OE I shpallur fitues GM Architecture sh.p.k nuk e ka te plotesuar Listen e Çmimeve .**

Siq besoj jeni te informuar kur nje OE ekonomik nuk e ka te plotesuar kete pjese duhet te refuzohet pasi qe eshte kusht administrative referuar : UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK te pika 10. Sqarimi i tenderëve gjatë

procesit të vlerësimit të tenderëve .

AK, në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim, me qëllim të cilin nuk e kuptojmë, ka shtrembëruar pretendimin tonë pasi ka thënë se kinse ne kemi thënë se OE nuk e ka listën e çmimeve.

Te pretendimi 2, ne kemi thënë se OE i shpallur fitues nuk e ka plotësuar Listën e Çmimeve, e cila është e vërtetë pasi që ne ju kemi bashkangjitur dëshmi se i njëjti nuk e ka plotësuar Listën e Çmimeve.

Referuar: UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, pika 10, Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, i cili e shpjegon qartë se cilat janë veprimet që duhen marrë në këtë rast kur:

Problemi-------*Lista e çmimeve nuk është plotësuar*

Si te veprohet-------*Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm*

Neni i LPP-së------- *Kusht administrativ*

Problemi------- *Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon*

Si te veprohet-------*Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm*

Neni i LPP-së------- *Kusht administrativ*

Andaj AK ka bere shkelje te LPP pasi qe per kete OE nuk e ka perdorur **UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK te pika 10. Sqarimi i tenderëve gjatë**

procesit të vlerësimit të tenderëve . Pas procesit te qasjes ne kemi verejtur se te gjithe OE kanë te plotesuar Listen e Çmimeve ne mnyre te njejte me

perjashtim te OE te shpallur fitues i cili nuk e ka te plotesuar Listen e Çmimeve.

Deshmi per kete pretendim mund ti gjeni ne shtojcen e dokumenteve

Pretendimi 4.Pasi që në procesin e qasjes nuk na është lejuar që të paktën ti shohim në mënyrë vizuale dokumentacionin e OE të shpallur fitues, GM Architecture sh.p.k., dhe duke ditur kërkesat e Dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, i cili është konkurs dhe dorëzimi është bërë në formë fizike, disa dokumente duhet të jenë të noterizuara dhe jo kopje të noterizimeve, ne supozojmë se OE i shpallur fitues nuk i ka përmbushur

kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale dhe nuk ka paraqitur stafin e kërkuarnga këto kërkesa sipas Dosjes Teknike (DT), si më poshtë:Ofertuesi duhet të ofrojë dëshmi se ka kryer dhe përfunduar projekte për arkiva dhe objekte të ngjashme me karakter administrativ-publik ku trajtohen hapësirat-depotëarkivore në vlerë prej 150,000.00 euro. Ne supozojmë se OE i shpallur fitues nuk i ka
përmbushur këto kërkesa.Të paraqesë listën e stafit inxhinierik me tituj inxhinier të diplomuar apo master, mepërvojë së paku pesë (5) vjeçare në lëmin e arkitekturës, ndërtimtarisë, makinerisë,elektros dhe hidros. Ne supozojmë se OE i shpallur fitues nuk i ka përmbushur këto
kërkesa.Gjithashtu, duhet të ketë edhe staf të certifikuar për njohuri të arritura në lëmin earkivistikës, të mbrojtjes nga zjarri dhe fikjes automatike nga zjarri me aerosoll.
Ne supozojmë se OE i shpallur fitues nuk i ka përmbushur këto kërkesa dhe nuk i ka dorëzuar diplomat dhe certifikatat të noterizuara (jo kopje të noterizimeve).
Andaj, duke iu referuar të gjitha atyre që u thanë më lart, kërkojmë që lënda të kthehet në **rivlerësim** dhe të bëhet vlerësimi i drejtë në bazë të ligjeve dhe udhëzimeve administrative të prokurimit publik.

Pretendimi 3 **OE I shpallur fitues GM Architecture sh.p.k nuk e ka te plotesuar Deklaraten nen Betim andaj bazuar ne UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK te pika 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve thuhet se pjesa e deklarates nen betim eshte kusht administrative dhe duhet te refuzohet tenderi pa kerkuar informacione shtese.**

Ne pergjigjen e AK I cili refuzon edhe kete pretendim pranohet se OE I shpallur fitues nuk e ka plotesuar siq duhet Deklaraten nen Betim por e justifikon me arsyen se nuk nderron asgje ne rezultatin final.Por bazuar ne UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK te pika 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve I cili eshte document ne baze te cilit tregohet se si duhet te vlersohet nje procedure e tenderimit saktesohet qarte se qfare duhet te veprohet ne kete situate.

Problemi------- *Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon*

Si te veprohet-------*Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm*

Neni i LPP-së------- *Kusht administrativ.*

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Duke mos bërë vlerësim të drejte nga ana e AK neve si OE pjesmarrës ne këtë

Aktivitet Prokurimi na ka shkaktuar dëme materiale në vlere prej 50,000.00 Euro përpërgaditejn e Dokumentacionit si dhe duke na pamundesuar qe kete aktivitet ta zhvillojme duke llogaritur fitimin e humbur.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*